

Rasti i të huajit jokomunitarë që nuk banon në Itali

Qytetarët jokomunitarë që nuk banojnë në Itali duhet të marrin vizën e hyrjes për punë autonome në Konsullatën ose Ambasadën italiane. Kërkesës së vizës duhet t'i bashkangjiten këto dokumenta:

- atestimi i parametrave ekonomike të dhëna nga "Camera di Commercio" e vendit ku dëshirohet të zhvillohet aktiviteti;
- deklarata e Autoriteteve publike që nuk ekzistojnë motive penguese për fillimin e aktivitetit (për shembull për shitjen me pakicë, verifikimin do t'a japë Komuna që verifikon kushtet për ushtrimin e aktivitetit).

Në rastin kur jokomunitari/-ja dëshiron të bëj pjesë në një Shoqëri ose kooperativë të regjistruar në "Registro Imprese" si bashkëpunëtorë ose administratorë, nuk kërkohet vërtetimi i parametrave financiarë. Por duhet të paraqisë në Ambasadë:

- Kopjen e deklaratës së përgjegjësisë që përfaqësuesi ligjor i shoqërisë ose kooperativës do të ketë parashikuar dërgimin në "Direzione provinciale del lavoro";
- Deklarata e përfaqësuesit ligjor i cili vërteton që kompensimi i shumës është më i lartë se niveli minimum i parashikuar nga ligji;
- Kopja e bilancit të fundit të aktivitetit të depozituar nga shoqëria.

Ndryshe është rasti i krijimit të një shoqërie të re, sepse kërkesat duhet të verifikohen nga një noter. Në të gjitha këto raste viza do të lëshohet vetëm nëse do të jetë e disponueshme një kuotë hyrjeje për punë autonome.

Pas marrjes së vizës është e detyrueshme kërkesa në Kuesturë e lejës së qëndrimit për punë autonome nëpërmjet postës. Leja e qëndrimit duhet të kërkohet brenda 8 ditëve punuese nga ajo e hyrjes në Itali.

Camera di Commercio di Viterbo

Tel. 0761 2341

www.vt.camcom.it

Via Fratelli Rosselli 4

01100 Viterbo

Settore attività connesse al Registro imprese

Tel. 0761.234452-457

Fax. 0761.345755

E-mail: registro.imprese@vt.camcom.it

Albo imprese artigiane

Tel. 0761.234438-439-428

Fax. 0761.234507

E-mail: marco.micheli@vt.camcom.it

Ufficio relazioni con il pubblico

Tel. 0761/ 234472/06

Fax 0761-234557

E-mail: urp@vt.camcom.it

Orari:

dal lunedì al venerdì
dalle 9,30 alle 12,30

Il lunedì e il giovedì
dalle 15,30 alle 16,30



Camera di Commercio
Viterbo

in collaborazione con

ImmigrazioneOggi

Krijimi i një aktiviteti! Një udhëzim i shkurt për qytetarët jokomunitarë të cilët dëshirojnë të ushtrojnë një aktivitet pune autonome



TUSCIA
VITERBESE

Qytetari jokomunitarë që jeton në Itali

Le të shikojmë rastin e parë që bën fjalë për qytetarin jokomunitarë i cili jeton në Itali.

Kushti kryesorë është paisja me "carta di soggiorno" ose "permesso di soggiorno CE per soggiornanti di lungo periodo" ose me njërën nga lejet e qëndrimit të mëposhtme:

- për punë autonome;
- për punë vartëse;
- për arsye familiare;
- për azil politik ose arsye humanitare;
- për personat pa shtetësi;
- për integrim të mituri.

Edhe studentët mund të ushtrojnë një punë autonome, por vetëm nëse shndërrojnë lejen e tyre të qëndrimit nga studim në leje qëndrimi për punë autonome.

Shndërrimi i lejes së qëndrimit për studio mund të bëhet në dy mënyra të ndryshme:

1) Ai që zotëron një leje qëndrimi për studim ose formim profesional akoma të vlefshme, që me arritjen e moshës tetëmbëdhjetë vjeçare ose pas mbrojtjes së diplomës universitare në Itali ose të specializimit dhe që dëshiron të ndërrojë titullin e "permesso di soggiorno" për punë autonome, mund të prezantojë kërkesën në "Sportello Unico" të prefekturës. Në këto raste, nuk nevojitet gatishmëria e një kuote. Por një student, nëse dëshiron të ushtrojë një aktivitet pune si sipërmarrës, si tregëtar ose si artizan, duhet të dimostrojë që të ketë mundësi ekonomike që duhet të jenë të vërtetuara nga Camera di Commercio.

2) Nëse i/e huaji/-a zotëron një leje qëndrimi për studim ose për formim profesional të vlefshme, por që nuk bën pjesë në rastet e përmendura më sipër, mund të prezantojë kërkesën e shndërrimit vetëm me paraqitjen e atestimit të Camera di Commercio. Në këtë rast mund të jetë i autorizuar vetëm nëpërmjet kuotave.



Pas marrjes së lejes së qëndrimit të parashikuar për ushtrimin e një aktiviteti ekonomik, qytetari/-ja jekomunitarë/-e mund të rregjistrojë aktivitetin e tij/saj në **“Albo delle Imprese Artigiane”** ose **“Registro delle Imprese”**.

Albo delle imprese artigiane

Cfarë duhet bërë për rregjistrimin e një aktiviteti në “Albo delle Imprese Artigiane”

Për rregjistrimin në Albo Artigiani janë të domosdoshme kushtet e mëposhtme:

- Aktiviteti duhet të ketë si objekt kryesorë prodhimin e pasurisë, edhe gjys-punuese, me përjashtim të aktivitetit agrar, tregtarë dhe të shpërndarjes së ushqimit dhe pijeve, siç mund të jetë një bar ose restorant.
- Aktiviteti mund të ushtrohet duke pasur të disponueshëm një autonomi organizative dhe strukturore dhe gjithashtu të jete i paisur me mjetet e nevojshme për prodhimin (të vërtetuara nga faturat blerëse ose certifikatat e pronësisë) ose të marrjes së drejtpërdrejtë në ngarkim të aktivitetit.
- Pronari i aktivitetit duhet të deklarojë që pjesa më e madhe e aktivitetit të tij punues derivon nga ndërmarrja artizane dhe puna e tij do të jetë jo vetëm drejtuese por edhe punë krah.
- Për ushtrimin e disa aktiviteteve të veçanta si (elektriciçtët, parukierët, autoriparuesit, autotransportuesit, firmat e pastrimit dhe hamallët) pronari duhet të zotërojë aftësi profesionale siç janë: eksperiencë pune ose një titull studimi. Nëse këto aftësi janë kryer në një shtet i cili nuk bën pjesë në Komunitetin Europian, duhet t'i kërkohet një certifikatë njohjeje Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, përndryshe

njohja e aftësive i përket Camera di Commercio ku bëhet kërkesa e rregjistrimit.

- Kurse për aktivitetet si psh. murator, montim mobiljesh, pronari duhet të stabilizojë vendbanimin e tij në njërin nga komunat e provincës.

Është e rëndësishme që aktiviteti artizan mund të ushtrohet në formën e një firme individuale dhe shoqërore.

Sapo kërkuesi të arrijë në këtë pikë duhet të paraqitet në Komunë në të cilën dëshiron të ushtrojë aktivitetin e tij brenda tridhjetë ditëve nga fillimi i punës. Komuna siguron kryerjen e mbikqyerjes së vendit ku ushtrohet aktiviteti dhe më pas do t'ja transmetojë në aktet në “Albo delle Imprese Artigiane”, pranë Camera di Commercio. Formulari për kryerjen e rregjistrimit mund të shkarkohet nga sitet e Camera di Commercio ose mund të kërkohet pranë Komunes. Formularit duhet t'i bashkangjiten, një dokument identiteti dhe leja e qëndrimit. Rregjistrimi kushton 31,00 euro për të drejtat e sekretarisë dhe një vulë prej 14,62 euro. Rregjistrimi në “Albo” është e nevojshme për lehtësimet e parashikuara për artizanët dhe lejon rregjistrimin automatikisht në I.N.P.S.

Registro imprese

Cfarë duhet të bëjë një person për të regjistruar aktivitetin e tij në Registro delle Imprese?

Nëse i/e huaji/-a nuk ka të gjitha kushtet për tu regjistruar në Albo Artigiani duhet të regjistrojë aktivitetin e tij në **Registro delle Imprese della Camera di Commercio**. Ky regjistrim duhet të kryhet gjithmonë brenda tridhjetë ditëve të fillimit të punës, dhe duke përdorur modelin 2 i cili mund të shkarkohet nga siti i Camera di Commercio ose mund të kërkohet direkt pranë zyrave Camerali. Modelit duhet t'i bashkangjiten gjithmonë një dokument identiteti dhe leja e qëndrimit. Edhe në këtë rast detyrimi i vulës është i barabartë me 14,62 euro kurse të drejtat e sekretarisë do të jenë 23,00 euro.

Për rregjistrimin në Registro delle Imprese nuk duhen karakteristika të veçanta vetëm ato profesionale dhe shkollore të parashikuara për aktivitetet e mëposhtme:

- Autoriparim
- Firmë pastrimi
- Firmë instalimesh të impianteve
- Firmë hamallësh
- Tregëti
- Shpërndarje ushqimesh dhe pijesh

Titujt e studimeve dhe ato profesionale, të kryera në një nga shtetet që nuk bën pjesë në Komunitetin Europian duhet të vlerësohen nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.